

ILIR HASHORVA
ANTISEMITIZMI

BOTIMET TOENA

ILIR HASHORVA

ANTISEMITIZMI

(Nga zanafilla fetare, te holokausti racist)

BOTIMET TOENA

Tiranë, 2022

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktore: Besa Vila

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike: Edona Marku

Kopertina: Mirjana Madhi

ISBN 978-9928-348-72-2

© Autori *dhe* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: botimet.toena@gmail.com

toena.porosionline@gmail.com

www.toena.al

PËRMBAJTJA

| | |
|-----------------|---|
| Parathënie..... | 9 |
|-----------------|---|

PJESA I ZANAFILLA - ANTISEMITIZMI FETAR

| | |
|---|-----|
| Hyrje..... | 15 |
| Pak nga historia e hershme e popullit hebre..... | 19 |
| Jezui dhe Testamenti i Ri sipas të krishterëve..... | 35 |
| Jezui dhe Testamenti i Ri sipas hebrenjve..... | 43 |
| Jezui dhe Bibla sipas zbulimeve të reja dhe studiuesve të pavarur..... | 49 |
| Jeta e Jezuit nuk përshkruhet nga asnjë historian i kohës..... | 53 |
| Ndodhi, persona dhe rite të mëparshme që përsëritën në Testamentin e Ri..... | 56 |
| Fe të mëparshme të ngjashme me krishterimin..... | 61 |
| Ngjashmëria e Jezuit me perëndi të mëparshme..... | 64 |
| Lindja e krishterimit..... | 70 |
| Talmudi..... | 77 |
| Antisemitizmi i Etërve të Kishës..... | 82 |
| Feja e krishterë bëhet fe zyrtare në Perandorinë Romake..... | 90 |
| Myslimanizmi dhe kryqëzatat e krishtera..... | 94 |
| Hebrenjtë në mesjetë, shpifjet dhe masat shtrënguese ndaj tyre..... | 100 |
| Shpifja e gjakut..... | 102 |
| Murtaja e zezë..... | 105 |
| Spanja, inkuizicioni..... | 110 |
| Protestantizmi..... | 115 |
| Hebrenjtë e shpërndarë në Europë në mesjetë..... | 119 |
| Çështja Dreyfus..... | 134 |
| Protokollet e Pleqësisë së Sionit..... | 136 |

PJESA II

VAZHDIMI - ANTISEMITIZMI RACIAL

| | |
|--|-----|
| Hyrje..... | 141 |
| Filozofët e nazizmit..... | 149 |
| Niçja - protonazisti..... | 151 |
| Gjermania në mbarimin e Luftës së Parë Botërore..... | 171 |
| Shkaqet që ndihmuan në ardhjen në fuqi të nazizmit..... | 177 |
| Krijimi i Partisë Nacionalsocialiste Gjermane..... | 181 |
| Hitleri..... | 185 |
| Përpyekjet e Hitlerit për pushtet..... | 197 |
| Terrori nazist | 207 |
| Propaganda naziste..... | 219 |
| Kishat gjermane në ndihmë të regjimit nazist..... | 230 |
| Higjiena raciale..... | 234 |
| Romët, bastardët e Luginës së Rinit, homoseksualët, Dëshmitarët e Jehovait..... | 240 |
| Ligjet naziste antisemite..... | 244 |
| “Nata e kristaleve”, apo “Nata e xhamave të thyer” | 256 |
| Fillimi i Luftës së Dytë Botërore..... | 263 |

PJESA III

PËRFUNDIMI - APOKALIPSI, HOLOKAUSTI

| | |
|---|-----|
| Hyrje..... | 275 |
| Gjenocidet..... | 282 |
| Grupet naziste të vrasjeve..... | 288 |
| Barbaria e nazistëve në vendet e pushtuara në bashkëpunim me vendasit..... | 299 |
| Konferenca e Vanze-së (Wannsee)..... | 304 |
| Kampet e përqendrimit dhe kampet e punës si armë të gjenocidit..... | 310 |
| Getoja e Varshavës..... | 320 |

| | |
|---|-----|
| Kampet e vrasjes..... | 323 |
| Shkenca vrasëse..... | 333 |
| Gjendja e hebrenjve në Europën e pushtuar nga nazistët..... | 337 |
| Drejt disfatës, marshimet e vdekjes | 348 |
| Rezultatet e Holokaustit..... | 354 |
| Hebrenjtë në Shqipëri gjatë luftës..... | 362 |
| Ditët e fundit të nazizmit..... | 367 |
| Heronjtë moralë..... | 373 |
| Pasthënie..... | 384 |

PARATHËNIE

Gjithnjë, kur kam analizuar diçka, jam udhëhequr nga parimi i së vërtetës, i drejtësisë dhe i shmangies së paragjykimeve. Pasi u njoha me Gandin dhe e studiova atë, këto parime m'u theksuan.

Për herë të parë kisha dëgjuar për hebrejntë apo, siç i quanim në atë kohë, çifutët, kur isha fare i vogël. Atëherë flitej për këtë apo atë tregtar që kishte lidhje pune me çifutët. Ata që kishin përvoja personale me ta, flisnin mirë, vinin në dukje seriozitetin dhe korrektesën e tyre; të tjerë flisnin keq, madje me përbuzje. Meqë s'kisha njohur kurrë ndonjë prej tyre, i përfytyroja në mënyra të ndryshme e të turbullta, gjithnjë të ndryshëm prej nesh. Kur aty nga fillimi i viteve 1950-të, në shtëpinë ku banonim, por nga një hyrje tjetër, te rruga e "Fortuzit", erdhi një familje çifute, pashë për herë të parë hebrej. Me djalin e asaj familjeje, me Zhakun, që ishim gati të një moshe, unë pak më i madh, u bëmë shokë e luanim bashkë. Pashë se nuk ishim të ndryshëm.

Më pas, dëgjova nga babai im të tregonte se, kur kishte qenë, aty nga fillimi i viteve 30-të, student në Firenze, i prenë bursën dhe mbeti ekonomikisht keq. Një grup hebrejsh, shokë të universitetit, e kishin marrë dhe e kishin çuar të hante në një nga restorantet e tyre, por e kishin paralajmëruar se ata në atë periudhë festonin Pashkët dhe buka do të ishte ndryshe, do të ishte pa maja. Ishin të shqetësuar nëse do ta hante dot atë bukë apo jo.

Kur u rrita dhe fillova të lexoja edhe anglisht, lexova librin e Dostojevskit "Shënime nga shtëpia e të vdekurve". Në të mbaj mend se si e përshkruante Dostojevski lutjen e një hebreu të internuar. Nëse nuk gaboj, lutja e hebreut, sipas Dostojevskit, i ngjante fillimisht një vajtimi, kalonte pastaj në gjendje neutrale qetësie dhe, në fund kalonte në nota gëzimi. Shpjegimi i lutjes ishte se hebreu fillimisht vajtonte Tempullin e Madh në Jerusalem, që u shemb e u dogj nga romakët rreth 1800 vjet më parë, pastaj vihej në mendime sesi do të mund të rikthehej tek ai Tempull, dhe, në fund, lumturohej, sepse do të rikthehej në Jerusalem dhe do të rindërtonte

Tempullin. Me sa kuptova më pas, lutja që përshkruan Dostojevski është ajo që bëjnë hebrenjtë në ditën e nëntë të muajit të tyre të Av-it, i cili bie midis korrikut dhe gushtit tonë, në të cilën ata përkujtojnë disa fatkeqësi, që u kanë ndodhur në të njëjtën datë të atij muaji, në shekuj të ndryshëm.

Kur pata rastin dhe fatin të shkoja për një specializim pune në Itali, në vitin 1981, ndërmjet të tjerave, mora pjesë edhe në një seminar ndërkombëtar dyjavor, në Eriçe, në Trapani, në Sicili, me pjesëmarrës nga shumë vende. Nga të gjithë pjesëmarrësit në atë seminar, në mënyrë të dukshme, binin në sy dy persona: njëri nga Anglia dhe tjetri nga Izraeli. Ata ishin më të kompletuarit, jo vetëm profesionalisht e kulturalisht, por, sidomos, shoqërisht. Ishin ata të dy që dallonin nga të tjerët për personalitete të plota gjithëpërfshirëse: i doje për sport, i doje për muzikë, i doje për humor, i doje për kulturë - i kishe për të gjitha. Kur pyeta njëherë hebreun se si qe e mundur që Izraeli përballoi dhe theu gjashtë ushtri të vendeve arabe, m'u përgjigj: "sepse luftoi cilësia me sasinë".

Gjatë viteve 80-90-të, u njoha me një hebre (quhej Robert) që m'u lut njëherë ta ndihmoja nga ana profesionale për një projekt që kishte lidhje me punën e tij. E ndihmova dhe në shenjë mirënjohje ma shpërbleu menjëherë me disa sende të vogla që mendoj se mua më duheshin për punën.

Kaq ishin njohuritë dhe përvojat personale për hebrenjtë pa vajtur në Amerikë, pra, që ishin fetarë, që ishin korrektë, që ishin të zgjuar e të kulturuar dhe që ishin mirënjohës. Në Amerikë, rasti e solli që të punoja me ta dhe t'i njihja më nga afër. Aty më lindi dhe interesi për njohjen e historisë së tyre.

Jo vetëm në Shqipëri, por edhe në botë, ka nga ata, sidomos nga ata që nuk u ka rënë rasti kurrë të njihen personalisht me hebrenjtë që, kur u flet për ta, të thonë: "e gjithë bota flet keq për ta, e gjithë bota nuk i do". Dhe, e ke të vështirë t'i kundërshtosh. Vërtet, bota jo vetëm i ka përbuzur, por edhe i ka trajtuar mizorisht. Për t'i kuptuar ata vetë dhe sjelljen e botës, apo të një pjese të saj, ndaj tyre, lexova dhe studiova me kujdes historinë dhe persekutimin e tyre. Prej këtyre leximeve dhe studimeve doli ky libër i thukët.

Shqiptarët nuk kanë ndonjë lidhje të drejtpërdrejtë me hebrenjtë dhe prandaj libri mund të duket si pa interes për ta, por, hebrenjtë, duke qenë të shpërndarë në të gjithë globin, e kanë historinë e tyre të lidhur me historinë e njerëzimit dhe të qytetërimeve të tij dhe, rrjedhimisht, pak a

shumë, edhe me atë të shqiptarëve. Historia e tyre lidhet me historinë e feve, për të cilat shqiptarët dinë fare pak ose aspak, dhe luftërave midis tyre. Ajo lidhet me historinë e një populli të shpërndarë nëpër botë që, përreth 1800 vjet nuk pati atdhe dhe, megjithatë, në kushte shumë të vështira, i ruajti me fanatizëm lidhjen dhe dashurinë për atdheun e vet të lashtë, për kulturën e tij, për traditat e tij, për fenë e tij. Ajo shërben si shembull përkushtimi për të gjithë - i një populli ndaj rrënjëve të tij. Nga ana tjetër, libri mund të paraqesë interes, sepse ai që e lexon me vëmendje, kupton menjëherë ngjashmëritë midis veprimeve dhe mendësive totalitare, qofshin ato të djathta apo të majta, ndaj atyre që konsiderohen armiq. Libri paraqet interes, sepse prej tij nxjerrim mësimin që të mos lejohen të lindin, të zhvillohen dhe të përhapen doktrina, ideologji a filozofi të urrejtjes, qofshin ato politike, fetare, etnike, shoviniste, racore, klasore, gjinore etj., se, po lindën dhe u zhvilluan, nuk shuhen lehtë.

E di që, për këto që shkruhet në këtë libër, do të ketë kritika, sepse mund të mendohet se qëllimi i shkrimit të këtij librit ka qenë ndryshimi i opinionit ndaj hebrenjve dhe judaizmit. Qëllimi nuk ka qenë fare ky. Qëllimi ka qenë për të ndihmuar sadopak ata pa paragjykime, por të interesuar për të vërtetën, për të mësuar diçka nga historia e hebrenjve si dhe për arsyet reale të përbuzjes dhe armiqësisë së një pjese të njerëzimit ndaj tyre.

Tani vonë, në një bisedë që pata me një njeri të kulturuar, ra fjala edhe për hebrenjtë, por ai ma preu shkurt: “Oh, ata unë nuk i dua”, kur e pyeta përse, nuk ishte në gjendje të jepte asnjë argument: “thjesht nuk i dua”, më tha dhe e mbylli bisedën. Dukej që ai ishte rob i paragjykimeve të tij, nuk dinte asgjë për ta dhe megjithatë i përbuzte. Kështu janë dhe miliona të tjerë.

Ilir Hashorva
Nju-Jork 2020

PJESA I
ZANAFILLA - ANTISEMITIZMI FETAR

HYRJE

Antisemitizmi është paragjykimi kolektiv më i hershëm në histori. Forca e tij, zotësia e tij për të mbijetuar, është e pashpjegueshme. Jo vetëm në lashtësi, por edhe në kohët moderne, argumentet antisemite janë krejt irracionale. Të gjithë antisemitët janë të bindur se hebrenjtë janë lakmitarë e të pangopshëm, se janë të vendosur për të arritur dominim mbi të tjerët dhe për të drejtuar punët e botës. Antisemitët i akuzojnë hebrenjtë njëkohësisht për të njëjtat gjëra, që janë dhe që s'janë. Ata i akuzojnë se janë shumë të pasur dhe se janë shumë të varfër; se janë shumë nacionalistë dhe se janë shumë kozmopolitë, se janë shumë fetarë dhe se janë shumë shekullarë.

Eli Vizel

Gjatë historisë janë mbajtur dogma të ndryshme si të vërteta absolute, si aksioma, dhe në bazë të tyre janë modeluar jeta dhe psikologjia e njerëzve të një epoke të caktuar. Kështu, në kohë të ndryshme, nga shoqëri të ndryshme, është besuar në mënyrë absolute te Zotat apo te Zoti, tek ekzistenca e magjive dhe magjistarëve, te fenomenet mbinatyrore, te superioriteti moral i burrave ndaj grave, te bota e rrafshët, te djallëzia e hebrenjve etj. Sot, shumë nga këto dogma apo besime duken absurde, por në kohën e tyre ato formonin vetëdijen e njerëzve dhe ndikonin mbi jetën në përgjithësi.

Bota në të cilën jetojmë nuk është e rastësishme. Ajo është produkt i shumë zgjedhjeve të bëra nga individë dhe grupe të ndryshme. Edhe vendime ose veprime, në dukje fare të vogla, mund të kenë ndikime të jashtëzakonshme në vende, popuj dhe kohë të ndryshme. Ndoshta do të duken paradoksale arsye time të tilla si: po ta kishin pranuar hebrenjtë Krishtin si Mesi, nuk do të kishte antisemitizëm dhe, po të mos kishte antisemitizëm, nazistët mund ta kishin fituar luftën, dhe, po ta kishin fituar nazistët luftën, sot do të ishin të zhdukur disa popuj. Ose, po të mos kishin dënuar padrejtësisht francezët oficerin hebre Drajfus, Herzeli nuk do të

ishte zhgënjyer nga urrejtja që pa ndaj hebrenjve në vendin e lirisë dhe të demokracisë, në vendin e Napoleonit, nuk do t'i shkonte mendja për krijimin e një shteti në Palestinë për hebrenjtë dhe sot ndoshta nuk do të kishte Izrael. Lidhje të tilla nuk janë fare pa baza. Mos vallë, pa dashje, antisemitizmi dhe, veçanërisht ai gjerman, duke u sjellë aq mizorisht me hebrenjtë, duke dashur t'i asgjësonte, i ndihmoi ata të rikrijonin shtetin e tyre pas 2 000 vjetësh?

Antisemitët i dimë? Po semitët cilët janë? Sipas legjendës, popullsia semite rrjedh praj Shemit, djalin të Noas, dhe përfshin shumicën e popujve të Lindjes së Mesme, por antisemitizmi në kuptimin që përdoret gjerësisht si term, është përbuzja dhe urrejtja ndaj vetëm njërit prej popujve semitë: ndaj hebrenjve. Ndoshta do të ishte më mirë e më saktë që antisemitizmi të quhej antihebraizëm, apo antijudaizëm. Megjithatë, le të vazhdojmë ta quajmë edhe ne urrejtjen dhe veprimet kundër hebrenjve antisemitizëm, ashtu siç është bërë zakon të quhet.

Ka një term tjetër që ngatërrohet me antisemitizmin. Ai është antisionizmi. Antisionizmi, pak më ndryshe nga antisemitizmi, është kundërshtimi i pasjes së hebrenjve të një shteti në Palestinë dhe urrejtja apo armiqësia ndaj atyre që e mbështesin atë shtet, ndonëse shpesh aty ku gjendet antisionizmi ndodhet edhe antisemitizmi dhe aty ku ndodhet antisemitizmi gjendet edhe antisionizmi. Është paradoksale, por është fakt, që ka edhe një sekt të judaizmit që, për arsye të ndryshme, e kundërshton rreptë sionizmin, pra krijimin, apo qenien, e një shteti hebre në Palestinë.

Ndonëse si term antisemitizmi është i ri, persekucioni ndaj hebrenjve ka mbi dy mijë vjet që zhvillohet. Antisemitizmi shprehet nëpërmjet paragjykitimit, dyshimit, urrejtjes, apo luftës së hapur ose të fshehtë ndaj hebreut, si person, por, sidomos, si grup etnik dhe fetar.

Akti i parë historik antisemit, tregohet në Bibël, në librin e Esterit. Këtu tregohet se si në shekullin e pestë para erës së re, shpëtoi për mrekulli pa u masakruar i gjithë populli hebre, që ndodhej në Persi, kur një zyrtar hebre, Mordekai, refuzoi të përkulej para ndihmësit kryesor të mbretit, Hamanit, prandaj ky vendosi të asgjësonte të gjithë hebrenjtë. Por, falë ndërhyrjes së gruas së mbretit, Esterit, që ishte hebreje, hebrenjtë shpëtuan. Kjo ngjarje përkujtohet edhe sot si një festë fetare judaiste që quhet "Purim".

Antisemitizmi ka kaluar në disa faza gjatë historisë. Fillimisht ai ka qenë pagan. Bota pagane, bota e feve me shumë zota, u ngrit kundër

hebrenjve të fesë monoteiste të fesë me një zot. Më pas, antisemitizmi pagan u shndërrua në antisemitizëm të krishterë dhe, akoma më pas, ai antisemitizëm u kthye në antisemitizëm racial. Antisemitizmi i fundit, që është më shumë antisizionizëm sesa antisemitizëm, është ai palestinez-arab, i cili ka pak motive fetare dhe raciale, por shumë motive etnike e territoriale.

Antisemitizmi pagan nisi në Aleksandrinë greke, në Egjipt, në shekullin e tretë para erës së re, ku gjendej komuniteti më i madh hebre i lashtësisë. Hebrenjtë në këtë qytet përcaktoheshin si mizantropë, si njerëz që qëndronin veç e larg popullsisë tjetër, si njerëz që shihnin vetëm punën dhe interesat e tyre, si njerëz që kishin zakone e rite të ndryshme e të çuditshme fetare. Hebrenjtë, duke mos pranuar fenë pagane greke dhe standardet sociale të tyre, shkaktuan zemërimin e grekëve dhe kundërvënien e tyre. Grekët përdhosën tempujt judaistë dhe ndaluan praktikat judaiste të rrethprerjes, të respektimit dhe krenimit të së shtunës si ditë të shenjtë, dietën judaiste, librat judaistë etj. Sulmet ndaj hebrenjve në këtë kohë u shoqëruan me shumë të vrarë.

Hebrenjtë e lashtësisë kanë jetuar midis shumë qytetërimeve: egjiptiane, babilonase, persiane, greke, romake etj. Kështu, historia e tyre është edhe historia e atyre qytetërimeve. Por, ndërsa ato qytetërime lulëzuan për periudha të caktuara kohore dhe pastaj u shuan, qytetërimi hebre dhe vetë hebrenjtë mbijetuan dhe vazhduan zhvillimin e tyre në qytetërime të reja.

Në lashtësi, kur një popull mundte një popull tjetër, ai e skllavëronte atë dhe populli i mundur duhej të adhuronte Zotat e popullit ngadhënjimtar. Hebrenjtë kudo që u ndodhën e sido që u ndodhën, vazhduan të bënin jetën e tyre: të mos njihnin Zotat e popujve të tjerë, të mos çonin dhurata në tempuj të tjerë, të mos merrnin pjesë në festivale që nderonin Zotat e popujve të tjerë. Ata refuzonin të punonin ditën e shtunë, refuzim që interpretohej si dembellëk dhe absurditet fetar, ata vazhdonin të kryenin rrethprerjen e djemve të tyre si një detyrim ndaj fesë së tyre.

Nevoja e hebrenjve për t'u shpërndarë nëpër botë, midis popullsive të ndryshme jomiqësore, ka lënë gjurmë tek ata dhe u ka modeluar në njëfarë mase edhe karakterin: ata janë tepër dyshues dhe gjithnjë syhapur për atë që ndodh përreth, por edhe tepër mirënjohës për ata që u tregohen miq. Hebrenjtë kanë jetuar në një botë jomiqësore, pa njohur kurrë aleatë të vërtetë, apo miq të qëndrueshëm.

Prej shekujsh, komunitetet hebreje kanë njohur periudha të shkurtra qetësie, paqeje dhe tolerance gjatë së cilave ndihej përnjëherë roli dhe përparimi i tyre, por këto periudha pasoheshin shpejt me persekucione, konvertime të detyruara, kryqëzata, inkuizicione, pogrome, masakra, gjenocide.

Sot hebrenjtë jetojnë në një botë ku kërcënimi fizik ndaj tyre hëpërhë është reduktuar, por refuzimi i tyre, ku më pak e ku më shumë, është ende i pranishëm.

Fetë në botë mund të ndahen në dy grupe të mëdha: në politeiste, në fe që besojnë se ka shumë Zota, dhe në monoteiste, në fe që besojnë se ka vetëm një Zot. Si fe bazë e monoteizmit është judaizmi dhe si fe bazë e politeizmit është hinduizmi. Fetë monoteiste janë doktrina moniste, pak apo aspak tolerante ndaj feve të tjera, madje edhe brenda grupeve të së njëjtës fe. Në të gjitha përleshjet ndërfejtare pothuajse gjithnjë, të paktën njëra palë do të ketë qenë një nga fetë monoteiste. Fetë politeiste janë më pluraliste, më toleruese, e pranojnë më lehtë të ndryshmen apo të kundërtën. Midis feve politeiste nuk ka pasur përleshje, si ka pasur dhe ka midis feve monoteiste. Në mjediset monoteiste feja judaiste, duke qenë fe në minoritet, ndonëse ishte feja “nënë”, u pa nga “fëmijët” e saj, nga krishterimi dhe myslimanizmi, si rivale dhe është goditur e denigruar pa reshtur prej tyre. Kur kjo fe është ndodhur midis feve politeiste, ajo ka jetuar në paqe me to. Judaizmit nuk i ka ndodhur asgjë në Indi, ose në vende të tjera të Lindjes së Lartë, por i ka ndodhur shumë në Europën e krishterë dhe në vendet myslimane, megjithëse duhet thënë se armiqësia në vendet myslimane, sidomos në ato arabe, është egërsuar pas krijimit të shtetit të Izraelit.

PAK NGA HISTORIA E HERSHME E POPULLIT HEBRE

Hebrenjtë krijuan një identitet të veçantë më herët se çdo popull tjetër që mbijeton sot. Historia e tyre zë në kohë tri të katërtat e historisë së njerëzimit, rreth 4 000 vjet, dhe shtrihet gati në të gjithë botën. Hebrenjtë e kanë ruajtur identitetin e tyre midis fatkeqësive të pafundme. Ata kanë jetuar midis shoqërive të ndryshme dhe kanë lënë gjurmë kudo ku kanë jetuar.

Çfarë i ka bërë hebrenjtë të veçantë? Ndoshta të qenët kudo dhe kurdo të shtypur, të përjashtuar, të dyshuar, të keqtrajtuar, të pafuqishëm, të përbuzur, shkurt, të vuajtur. Këto, sipas pastorit gjerman, Ditrih Bonhofer, ndonëse të paguara shtrenjtë, u kanë dhënë atyre një përvojë të paçmuar e të pakrahasueshme. Që në stadet e para të ekzistencës së tyre ata besuan se kishin zbuluar një plan hyjnor për racën njerëzore, në të cilin shoqëria e tyre do të kishte një rol parësor. E dhanë atë plan me shumë hollësi dhe iu përmbajtën atij, pa marrë parasysh asgjë. Shumë prej tyre besojnë ende në atë plan.

Asnjë popull nuk mbeti i lidhur emocionalisht aq gjatë dhe aq shumë me një tokë, sa hebrenjtë me tokën e të parëve të tyre, ndonëse shumica e tyre, pothuaj mbi tri të katërtat e kohës, e kaloi jashtë vendit të tyre.

Historia katërmijëvjeçare e hebrenjve fillon në Hebron. Në Hebron, tani në Bregun Perëndimor të administruar nga palestinezët, të vendosur në kodrat e Judesë, nja tridhjetë kilometra në jug të Jerusalemit, në shpellën e Mahpelahut, të cilën Abrahami e kishte blerë si vend për varrosjen e tij dhe të gruas së tij, Sarës, ndodhen varret e patriarkëve dhe matriarkëve të hebrenjve: të Abrahamit, themeluesit të fesë judaiste dhe paraardhës i hebrenjve; përkrah tij është varri i gruas së tij, Sarës; aty pranë janë varret e djalit të tij, Isakut dhe gruas së tij, Rebekës; pak më tej janë varret e nipit të tij, Jakovit dhe gruas së tij Leas; përsëri, pak më tej është varri i djalit të tyre Jozefit. Në këtë vend janë ngritur me radhë: Tempull hebre, sinagogë, kishë bizantine, xhami, kishë e kryqtarëve dhe, pastaj, përsëri xhami. Hebroni tregon historinë tragjike të hebrenjve dhe zotësinë e tyre

të jashtëzakonshme për të mbijetuar përmes fatkeqësive. Nga viti 1266 hebrenjtë u ndaluan të hynin në atë shpellë për t'u lutur. Por, ku janë sot ata popuj që dikur u vendosën në Hebron? Ku janë kananitët, ku janë edomitët, ku janë grekët e vjetër, ku janë romakët, ku janë bizantinët, ku janë mamlukët, ku janë otomanët? Të gjithë këta u zhdukën, hebrenjtë mbetën.

I vetmi burim për historinë e hershme të popullit hebre, është Bibla Hebraike, siç e quajnë hebrenjtë, apo Testamenti i Vjetër, siç e quajnë të krishterët. Se ç'pjesë e saj është vërtet histori dhe ç'pjesë është mit, nuk mund të thuhet. Shumica e festave fetare të hebrenjve lidhen me historinë që tregohet në Bibël dhe kanë për qëllim ta bëjnë hebreun e sotëm të kujtojë, të nderojë dhe të ndjekë paraardhësit e tij të lashtë dhe traditat e tyre. Ndërsa popuj të tjerë kanë paraqitur për historinë e tyre vetëm pjesë epike kombëtare për të inkurajuar krenarinë, hebrenjtë janë përpjekur të zbulojnë se edhe çka ka vajtur keq në historinë e tyre, edhe çka ka vajtur mirë. Për këtë arsye Bibla e tyre ka plot pjesë ku hebrenjtë paraqiten si popull mëkatar, si popull që nuk i është bindur ligjit të Zotit. Kjo i ka bërë ata më realistë dhe më të kujdesshëm në jetën e tyre të mëpasshme dhe në politikat që kanë ndjekur.

Libri i parë biblik, “Zanafilla”, fillon me Zotin e plotfuqishëm që, afro 6 000 vite më parë, në gjashtë ditë krijoi botën nga kaosi. Njeriun Ai e krijoi në ditën e fundit, në ditën e gjashtë dhe në ditën e shtatë, bëri pushim.

Pas një sërë gjeneratash, si thuhet në Bibël, njerëzit u larguan nga rruga e drejtë për të cilën i kishte krijuar Zoti dhe prandaj Ai vendosi t'i zhdukte të gjithë me anë të një përmbytjeje universale, duke lënë vetëm Noa-n së bashku me familjen e tij, të cilët ishin njerëz të mirë, si dhe speciet e ndryshme të kafshëve. Noa kishte tre djem. Njëri prej tyre ishte Shemi, pasardhësit e të cilit krijuan ata që u quajtën “Popuj Shemitë”, apo Popuj Semitë. Këta janë në përgjithësi popujt e Lindjes së Mesme. Pasardhësi i njëmbëdhjetë i Shemit ishte Abrahami, figura kyç e monoteizmit: e judaizmit, e krishterimit dhe e myslimanizmit. Historia e judaizmit fillon rreth 4 000 vjet më parë me Abrahamin, ajo filloi me një udhëtim dhe do të vazhdonte përjetë me udhëtime.

Abrahami kishte lindur në qytetin Ur, në Mesopotami, pjesë e Irakut të sotëm, në vitin 1928 që nga krijimi i botës, sipas kalendarit hebraik, apo rreth 3 800 vjet më parë. Thuhet se u urdhërua prej Zotit që të linte qytetin

e tij të lindjes dhe të shkonte në vendin e quajtur Kanan, ku do të krijonte një komb të ri, të cilin do ta trashëgonin pasardhësit e tij për ta bërë një komb të madh. Që të shkonte në Kanan, Abrahami, së bashku me njerëzit e familjes së tij, duhej të kalonin lumin Euftrat. Abrahami me njerëzit e tij, që filluan migrimin, u njohën në Bibël me emrin *Ivrim*. *Ivrim*, në hebraisht, do të thotë “njerëzit që kaluan lumin”, apo “njerëzit nga ana tjetër e lumit”. Vetë hebrenjtë sot e quajnë veten e tyre *jahudinj* dhe gjuhën e tyre e quajnë *ivrit*. Emrat *zhid*, *xhu*, *jude*, *jahudi*, *çifut*¹, *ebreo* etj., me të cilët i njeh bota, sipas gjuhëve të ndryshme, rrjedhin nga emri i fisit hebre i Judës, fis i pasardhësve të njërit prej 12 djemve të Jakovit (Izraelit).

Këtu po hapim një parantezë: në Shqipëri ai popull është njohur deri vonë vetëm me emrin “çifut”, emër që mund të jetë me prejardhje turke, që është i ngjashëm edhe me fjalën që përdoret në anglisht dhe në frëngjisht për të. Është përhapur mendimi ndër shqiptarë se ajo fjalë është fyese për ta, prandaj nuk duhet përdorur e, në vend të saj, duhet të përdoret fjala “hebre”, fjalë që është e ngjashme me atë që përdoret në gjuhët italisht dhe rusisht. Asnjë prej atyre që ngulin këmbë për këtë zëvendësim, nuk ka dhënë ndonjë argumentim bindës, përveçse kanë përsëritur mendimin se fjala çifut nuk u dashka përdorur se ka kuptim përkeqësues dhe se ai popull u fyeka po ta quash ashtu. Nga kontaktet që kam pasur me shumë çifutë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, i kam pyetur nëse kishte për ta ndonjë kuptim fjala çifut. Asnjë nuk dinte gjë për të dhe asnjërit nuk i bënte përshtypje ajo fjalë. Një grua çifute, e rritur në Turqi, më tha se, kur kishte qenë e vogël, fëmijët turq i shanin me shprehjen “pis çifut” dhe prandaj mendonte se fjala çifut ishte fyese apo përçmuese. Por, kjo nuk do të thoshte se vetë fjala çifut i jepte asaj shprehjeje një kuptim negativ. Në atë shprehje kuptimin negativ e krijonte fjala “pis”. Është e njëjta gjë edhe me shprehjen që përdornin turqit kundër nesh: “pis arnavut”. Ngarkesën negative nuk e përmban fjala arnavut, ngarkesën negative e përmban fjala “pis”, i ndyrë. Duket se ata që kanë ngulur këmbë të parët në përdorimin e fjalës hebre dhe në heqjen nga përdorimi të fjalës çifut, janë nisur më shumë nga lidhjet që kanë pasur ata vetë me gjuhët italisht apo rusisht dhe jo nga ndonjë konsideratë reale për të mirën e atij populli, apo nga ndonjë kërkesë e gjuhës shqipe.

Në përgjithësi, për të emërtuar atë popull përdoren pa kujdes termat hebre, çifut, ose izraelit, terma që nuk janë sinonime. Termi hebre ka lidhje

me etnitë që rrodhën nga pasardhësit e kryepatriarkut Abraham dhe që flisnin gjuhën hebraisht. Termi izraelit ka lidhje me një pjesë të popullit hebre, me pasardhësit e dymbëdhjetë djemve të patriarkut Jakob, nipit të Abrahamit, që u quajt edhe Izrael, prej të cilëve u krijuan dymbëdhjetë fise të ndryshme. Këto fise, pasi qëndruan për shumë kohë e breza në Egjipt si skllevër, u larguan dhe pushtuan Kananin, Izraelin e sotëm. Në kuptimin bashkëkohor, termi izraelit përdoret për të quajtur shtetasit e Izraelit të sotëm, të cilët janë me etni dhe fe nga më të ndryshmet. Termi çifut ka lidhje me të gjithë ata që ndjekin fenë judaiste, kudo që ndodhen.

Në raste të veçanta një çifut (në kuptimin judaist, i fesë judaiste) mund të mos jetë hebre, kur ai nuk ka prejardhje nga prindër që kanë lidhje me Jakobin, por ka përqafuar fenë judaiste, dhe një hebre mund të mos jetë çifut, kur ai ka prejardhje nga Jakovi, por nuk praktikon fenë judaiste, ose është konvertuar në një fe tjetër. Një shembull shumë kuptimplotë është Krishti. Ai ishte hebre, ishte izraelit, ishte çifut, por dishepujt e larguan nga feja judaiste, nga feja çifute dhe prej tij krijuan fenë e krishterë.

Sot në shqip përdoren të dyja fjalët, por zakonisht ata që e përçmojnë atë popull përdorin fjalën çifut, të tjerët përdorin fjalën hebre. Vetëm për këtë arsye unë do të përdor në këtë libër fjalën hebre dhe jo çifut që të mos identifikohem në Shqipëri me ata që kanë urrejtje për atë popull.

Tashti vazhdojmë. Rrugës për të shkuar në Kanan, Abrahami pati një takim me Zotin, me Jehovain, diku në Turqinë e sotme. Zoti i propozoi këtë pakt apo këtë besëlidhje Abrahamit: në qoftë se Abrahami do të zbatonte urdhëresat e Tij, Ai do t'i bënte pasardhësit e Abrahamit popullin e tij të zgjedhur dhe do ta mbronte. Nga ana e tij, Zoti pati vetëm një kërkesë: meshkujt, pasardhës të Abrahamit, në ditën e tetë të lindjes, duhej të bëheshin synet. Si shpërblim për këtë, ata do të trashëgonin tokën e Kananit.

Që Abrahami të kishte pasardhës, duhej të lindte fëmijë, por gruaja e tij, Sara, ishte shterpë dhe që të dy, ai dhe Sara, ishin në moshë të shkuar. Atëherë, gruaja i kërkoi Abrahamit që të lindte një fëmijë me shërbyesën e saj, me Hagar-in, që ishte egjiptiane. Abrahami lindi me të një djalë që e quajti Ishmael, apo Ismail. Pasardhësit e Ishmaelit u bënë popujt arabë. Pas lindjes së Ishmaelit, Abrahami lindi një tjetër djalë me gruan e tij, me Sarën. Djali u quajt Isak dhe pasardhësit e tij u bënë hebrenjtë. Isaku pati një djalë që e quajti Jakov e që më pas do të quhej Izrael. Jakovi, apo

Izraeli, pati dymbëdhjetë djem prej të cilëve u krijuan dymbëdhjetë fise hebrejsh.

Gjatë qindra viteve të para të ekzistencës hebrejsh dalloheshin nga popullsitë e tjera përreth nga adhurimi i vetëm një Zoti të pavdekshëm e të gjithëfuqishëm, nga ritet e synetllëkut, nga ndalimi i kurbaneve njerëzore, që në atë kohë zhvilloheshin ende, si dhe nga kremtimi i ditës së shtunë, e cila i dedikohej krejtësisht Zotit. Meqenëse Zoti i hebrejve ishte i pavdekshëm, nuk kishte sesi të ringjallej dhe hebrejsh hoqën dorë nga ritet e ringjalljes së Zotave të paganëve. Meqenëse kishte vetëm një Zot, nuk mund të kishte hierarki midis Zotave, as luftë midis tyre e as midis besimtarëve të tyre. Hebrejsh hoqën dorë nga ritet e fertilitetit dhe nga ritet erotike, të cilat zbatoheshin nga popujt përreth.

Pas një thatësire të gjatë, që solli urinë në Kanan, të dymbëdhjetë djemtë e Jakovit shkuan në Egjipt, ku për rreth 400 vjet u shtuan e u bënë mijëra e mijëra, duke krijuar dhe zmadhuar secili fisin e tij. Në fillim Egjipti i mbajti mirë, por më pas ai i ktheu në skllavëri. Duke mos e duruar dot skllavërinë, të udhëhequr nga prijësi i tyre, Moisiu (Moshe), që kishte pasur më parë një takim me Zotin, në të cilin Ai e kishte urdhëruar të merrte popullin e tij e ta nxirrte nga skllavëria e Egjiptit, duke e çuar në tokën që i ishte premtuar Abrahamit; hebrejsh vendosën të arratiseshin për në Kanan, të kryenin, pra, atë që u quajt eksod. Pas shumë pengesash, 40 vitesh endje nëpër shkretëtirë, Moisiu arriti pranë Kananit, por nuk mundi të hynte dot aty, sepse vdiq, ndërsa ata që e pasuan hynë në Kanan, në Izraelin e sotëm. Gjatë rrugës nëpër shkretëtirë, Moisiu pati një takim tjetër me Zotin në malin Sinai. Aty, Zoti i paraqiti Moisiut disa qindra rregulla, që u përfshinë më pas në ato që quhen Pesë librat e Moisiut, ose Tora (fjala Tora do të thotë instruksione, mësim), apo Bibla Hebraike, ku zënë vend edhe Dhjetë Urdhëresat e famshme të gdhendura me gishtin e Tij në dy pllaka guri. Ato rregulla duhej t'i zbatonte populli hebre, në mënyrë që të kishte mbështetjen e Tij. Pranimi i atyre rregullave nga hebrejsh e bëri Zotin që t'u premtonte atyre se andej e tutje ata do të ishin "Populli i Tij i Zgjedhur". Kjo do të përbënte atë që do të quhej "Besëlidhja me Zotin e popullit hebre". Ideja e "Popullit të Zgjedhur" u interpretua nga të tjerët si deklaratë raciste e superioritetit të hebrejsh, gjë që do t'u sillte telashe gjatë historisë.

Në qoftë se Abrahami është ati e paraardhësi i popullit hebre, Moisiu është krijuesi i popullit judaist; përmes tij hebrejsh u bënë një popull i

veçantë me një fe të përcaktuar. Moisiu është profeti, ligjvënësi dhe udhëheqësi hebre. Ndonëse është një figurë tepër e madhe, në Bibël Moisiu nuk paraqitet kurrë si një mbinjeri. Ndryshe nga të tjerët në antikitet që i, hyjnizonin figurat e tyre themeluese, dijetarët hebrej vinin në dukje edhe dobësitë njerëzore dhe dështimet e tyre.

Ndonëse Moisiu është figura më e rëndësishme në historinë dhe fenë e hebrejve, ndonëse çmohet e nderohet, nuk përkujtohet. Për të nuk është caktuar asnjë festë fetare. Në të Pesë Librat e Moisiut, nuk përmendet asnjë frazë që t'i atribuohet atij. Ndonëse Moisiu udhëhoqi hebrejtë drejt lirisë, në tregimin që hebrejtë e përsërisin çdo vit në festën e Pashkëve në kujtim të Eksodit, emri i Moisiut përmendet vetëm kalimthi.

Të Pesë Librat e Moisiut, Tora, që thuhet se Moisiut ia transmetoi Zoti në malin Sinai, (një shënim këtu: Mali Sinai nuk dihet se ku ka qenë. Ai që quhet Manastiri i Sinait ka qenë gjithnjë një vend i krishterë që nga shekulli i katërt pas erës së re), është libër ligjesh, kanunesh e kodesh sjelljeje dhe drejtësie tepër i avancuar për kohën. Konceptet e tij të demokracisë, të drejtësisë, të barazisë së të gjithëve para ligjit, të një ligji të shkruar, ishin të habitshme jo vetëm për kohën që u shkruan, por edhe për shumë kultura të kohës së sotme. Pas Kodit më të hershëm, atij të Ur Namut, i vitit 2050 para erës së re në Mesopotami dhe Kodit të Hamurabit të Babilonisë, aty nga vitet 1771 para erës së re e që ndodhet edhe sot në formë të shkruar me 282 nene, ishte Moisiu që hartoi ligjin tjetër juridik, aty nga vitet 1200 para erës së re, me 613 nene, apo urdhëresa, prej të cilave 365 (aq sa janë ditët e vitit) ishin urdhëresa negative, pra veprime që nuk duheshin bërë dhe 248 (aq sa mendohej që ishte numri i kockave të njeriut, plus organet e tij më të rëndësishme) ishin urdhëresa pozitive që kishin lidhje me veprimet që duheshin bërë. Ndryshe prej kodeve të mëparshme, që thuhej se ishin frymëzuar nga Zoti, por ishin shkruar prej mbretërisht dhe mund të ndryshoheshin ose të revokoheshin nga mbretër pasardhës, kodi i Moisiut ishte dhënë nga Zoti dhe nuk mund të ndryshohej në të ardhmen nga askush, as nga mbretërit.

Ligji u hartua për të krijuar një shoqëri harmonike, një shoqëri që të funksiononte, një shoqëri në të cilën secili të dinte të drejtat dhe detyrat e tij. Ai ligj pati ndikim të madh edhe në kodet juridike të shoqërive të tjera të mëpasshme. Pas ligjit hebre, ligji tjetër i shkruar u hartua nga romakët rreth 1 300 vjet më pas.

Ligji i Moisiut do t'i bënte hebrenjtë akoma më të ndryshëm krahasuar me popujt e tjerë. Ligjet kishin të bënin me marrëdhëniet e njeriut me njeriun, me marrëdhëniet e njeriut me shtetin dhe me marrëdhëniet e njeriut me Zotin. Ligjet e Moisiut paraqitën parimet e ndarjes së fesë prej shtetit, parime që për botën tjetër do të zbatoheshin rreth 3 000 vjet më pas. Autoriteti civil do të ishte i ndarë prej atij fetar. Feja ngarkohej me mbajtjen e shtetit brenda suazës së ligjeve. Diçka e ngjashme me këtë ide janë Gjykatat Kushtetuese të sotme që, ndonëse nuk janë mbi qeveritë, i mbajnë ato brenda ligjeve kryesore, brenda Kushtetutës. Sipas Ligjeve të Moisiut, skllëverit trajtoheshin me më shumë humanizëm nga ç'trajtoheshin skllëverit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës 3 000 vjet më pas. Të gjitha ligjet e bëra për njerëzit e lirë zbatoheshin edhe për skllëverit, të cilët duhej të fitonin lirinë 7 vjet pas zgjedhës. Sipas Urdhëresës së Dytë, ndalohej paraqitja e imazhit të Zotit. Zoti do të ishte i padukshëm, ai nuk do të kishte as emër, as pamje, ai do të ishte qenie thjesht shpirtërore. Por, nga ana tjetër, kjo ndalesë pengoi zhvillimin e shpirtit artistik të hebrenjtë. Prej tyre, për një kohë të gjatë, nuk pati piktorë, skulptorë apo arkitektë të shquar. Profesionit të tyre kombëtar ishte shkrimi. Ata kanë krijuar sasinë më të madhe të shkrimeve të antikitetit, ku Testamenti i Vjetër përbën vetëm një pjesë të tyre. Të krishterët, që lejuan pamjet vizuale të shenjtoreve të tyre, jo vetëm zhvilluan shpirtin artistik të besimtarëve, por i bënë mjediset e tyre më të bukura dhe fenë e tyre më të kapshme nga besimtarët.

Pas arritjes në Kanan, aty nga viti 1250 para erës së re, hebrenjtë mundën popullsinë vendase kananite, një popullsi që kishte një fe që përdorte kurbanin njerëzor për perëndinë e zjarrit, Moloh-un, e që kishte rite të ndyra "të shenjta" të riprodhimit që lidheshin me orgji dhe prostitucion. Hebrenjtë nuk paraqitën ndonjë keqardhje që u zunë vendin kananitëve të cilët, sipas tyre, ishin ndëshkuar nga Zoti për arsye të mëkateve të tyre. Hebrenjtë e ndanë vendin që u quajt, sipas kohës: Kanan, Izrael, Jude, Palestinë, dhe, më në fund, përsëri Izrael, në pjesë, ku secili nga 12 fiset e djemve të Jakovit pati nga një pjesë, duke krijuar 12 provinca. Të dymbëdhjetë fiset hebreje ishin të pavarura dhe të ndara nga njëra-tjetra. Ato mblidheshin vetëm në raste nevoje. Këto fise më pas formuan një konfederatë, por pa qeveri qendrore dhe pa kryeqytet. Ata bashkoheshin nga prejardhja dhe nga një sërë zakonesh e ritesh. Në qytetin Shiloh, që mund të konsiderohet si qendra e tyre, ata ngritën një Tempull dhe aty

vendosën Arkën e Kovenantës, apo Arkën e Besëlidhjes, në të cilën ishte vendosur pllaka prej guri ku ishin gdhendur Dhjetë Urdhëresat që Zoti ia kishte dhënë Moisiut në malin Sinai.

Rreth zonës që zunë hebrenjtë, jetonin edhe filistinët, ata që sot quhen palestinezë, të cilët, ashtu si hebrenjtë, ishin një popull i ardhur. Këta quheshin popull i detit, pasi mendohej se kishin ardhur nga ishujt e Detit Egje, ndoshta nga Kreta. U vendosën në bregun jugor, duke dëbuar prej aty kananitët dhe duke u përpjekur të dëbonin edhe hebrenjtë, sidomos nga Judeja.

Për të mbajtur vendin në rregull, hebrenjtë duhej të organizonin shtetin, duhej një autoritet qendror, një mbret dhe një ushtri e përbashkët.

Në vitin 1020 para erës së re, u kurorëzua mbreti i parë i hebrenjve, Sauli, nga profeti Samuel. Pas tij erdhi Davidi, i cili e bashkoi pushtetin politik me atë fetar te vetja, duke krijuar një drejtim shumë autoritar. Davidi u bë mbreti më i suksesshëm dhe më popullor në Izrael. Edhe pas 2 000 vjetësh mbretëria e tij konsiderohet si mbretëria e artë. Davidi mundi përfundimisht filistinët dhe i mbylli ata në një rrip të ngushtë toke, në Gaza. Ai themeloi kryeqytetin, Jerusalem dhe sollti aty Arkën e Besëlidhjes. Davidi kishte qenë një oficer i dalluar në ushtrinë e Saulit, ishte ai që kishte mundur në një dyluftim heroin filistin Goliath. Davidi u shqua si mbret dhe si luftëtar, por jo si njeri moral. Ai, për t'i marrë gruan një oficeri të tij, e çoi në luftë që të vritej. Pas vrasjes së tij, u martua me gruan e tij, Bathsheba-n, me të cilën lindi një djalë që e quajti Solomon. Pas Davidit, mbret u bë Solomoni. Solomoni e zhvilloi së tepërmi vendin nga çdo pikëpamje. Ai ndërtoi në Jerusalem Tempullin e Madh ku, që nga ajo kohë, do të përqendrohej e gjithë jeta fetare e hebrenjve. Në atë Tempull u vendos edhe Arka e Besëlidhjes. Ndërsa Davidi e forcoi dhe e zgjeroi mbretërinë e tij me luftë, Solomoni e ruajti atë me paqe.

Pas vdekjes së Solomonit, plasën grindje midis fiseve hebreje dhe vendi u nda në dy pjesë. Dhjetë nga dymbëdhjetë fiset krijuan në veri shtetin që u quajt Izrael, me kryeqytet Samaria-n, dhe dy fise të tjera krijuan në jug shtetin që u quajt Jude, me kryeqytet Jerusalem.

Në vitin 721 para erës së re, Asiria, një shtet i fuqishëm i kohës, që shtrihej në veri të Irakut të sotëm dhe në Siri, pas një lufte dhjetëvjeçare, e mundi Izraelin. Asirianët i dëbuan të dhjetë fiset izraelite nga vendi i tyre dhe që nga ajo kohë ato fise u zhdukën nga historia. Kështu, mund të thuhet

se Holokausti i parë i vërtetë i hebrenjve ndodhi kur asirianët zhdukën dhjetë fiset hebreje, të cilat u asimiluan nga popullsia fqinje aramaike.

Si shtet i hebrenjve mbeti vetëm Judea, e cila, deri në vitin 586 para erës së re, mbeti shtet i pavarur, duke iu bërë ballë shumë përpjekjeve të superfuqive të kohës për ta pushtuar.

Në vitin 586 para erës së re, Babilonia, një shtet shumë i fuqishëm i kohës, me shtrirje në Irakun e sotëm, shteti që mundi dhe zhduku asirianët, pushtoi shtetin e mbetur hebre, Judenë. Babilonasit iu shkatërruan hebrenjve Tempullin e Madh në Jerusalem ku bëhej e gjithë jeta fetare. Kjo ndodhi në ditën e nëntë të muajit hebre të Av-it (sipas kalendarit tonë muaji i av-it bie midis muajve korrik dhe gusht), dhe, bashkë me të, edhe të gjithë infrastrukturën e vendosur të jetës fetare judaiste. Siç ishte zakoni në ato kohë, shteti fitimtar i çonte popujt e mundur në vendin e tij si skllëvër. Një numër hebrenjsh, nga elita e vendit, u detyruan të shkonin në Babiloni. Këta hebrenj nuk u zhdukën nga historia, ashtu siç u zhdukën vëllezërit e tyre të mbretërisë së veriut, rreth një shekull e gjysmë më parë.

Më pas, që nga ajo kohë e deri në shekullin e njëzetë, Judea u pushtua apo u kontrollua me radhë nga superfuqi të kohës: nga grekët e Aleksandrit të Madh, nga romakët, nga Perandoria Bizantine, nga myslimanët, nga kryqëzatat e krishtera, nga Perandoria Otomane dhe, së fundi, nga Perandoria Britanike. Kjo pjesë e historisë së tyre, që është edhe më e re, është më e dokumentuar.

Babilonasit u treguan më tolerantë sesa asirianët me hebrenjtë. Ata i lejuan ata të praktikonin fenë e tyre dhe në atë mënyrë të ruanin identitetin e tyre. Mërgimi e bëri popullin hebre të bashkohej më shumë dhe të theksonte më tepër simbolet fetare të tij.

Ndërkohë, hebrenjtë kishin nxjerrë profetët e tyre. Profetët hebrenj, ashtu siç ishin apo do të ishin edhe profetët e feve apo popujve të tjerë, qenë persona që besohej si të dërguar nga Zoti, për t'i treguar njerëzve rrugën e mbarë, rrugën e virtytit. Profetët e parë për hebrenjtë qenë Amosi dhe Hosea.

Më pas, rëndësi patën dy profetët e tjerë: Isaia dhe Jeremia. Këta e përgatitën popullin hebre që të mbijetonte edhe po të detyrohej të largohej nga vendi i tij. Këta thanë se rituali, kulti dhe, sidomos, Tempulli nuk kishin rëndësi për Zotin. Për Të kishin rëndësi humanizmi, morali dhe drejtësia. Zoti nuk dëshironte kurbane, prandaj nuk ishte mëkat të mos

bëje kurbane. Për ta, mëkat ishte korrupsioni dhe perversioni i drejtësisë. Në këtë kohë mori formë dhe ëndrra mesianike judaiste, ëndërr që kishte lidhje me ardhjen e një shpëtimtari që do të vinte rregull në botë. Isaia paraqet për herë të parë një figurë shpëtimtare të veçantë, ai thotë: “Vini re, do të mbarset virgjëresha dhe do të sjellë një djalë që do ta quajë Imanuel (që do të thotë ‘Zoti me ne’), i cili do të qetësojë botën: ‘Ujku do të rrijë me qengjin dhe leopardi me fëmijët...’ Ky do të jetë edhe një drejtues i madh dhe do të quhet I Mrekullueshmi, Këshilltari, Zoti i Fuqishëm, Ati i Përherëshëm, Princi i Paqes”.

Në Babiloni, hebrenjtë në vend të Tempullit, ndërtuan sinagogat dhe në vend të ritualeve dhe kurbaneve për Zotin, ata vunë lutjen ndaj Zotit. Me sinagogat dhe lutjet, hebrenjtë nuk ishin më të lidhur me ndonjë vend, me ndonjë Tempull apo kohë të caktuar. Feja judaiste deri tashti e ngurtësuar te Tempulli i Madh në Jerusalem, do të bëhej elastike. Mbijetesa në një vend të huaj do të ishte më e lehtë.

Perandoria Babilonase nuk jetoi gjatë. Në vitin 538 para erës së re, ajo u mund dhe u pushtua nga persët. Persianët ishin shumë më tolerantë ndaj popujve të pushtuar. Nga e gjithë historia katërmijëvjeçare e hebrenjve, hebrenjtë kanë njohur vetëm një dashmirës: mbretin Sirus të Persisë. Ai, në vitin 535 para erës së re, i lejoi hebrenjtë skllëvër në Babiloni të ktheheshin në atdhe, në Jude, e cila tashmë ishte kthyer në provincë persiane. Hebrenjtë e kthyer rindërtuan Tempullin e Madh, rindërtim që zgjati 20 vjet.

Gjatë viteve 450 para erës së re, u dalluan dy profetë të tjerë hebrenj: Nehemia dhe Ezra. Këta ishin të parët që vendosën të ndalonin martesat midis hebrenjve dhe johebrejve. Ky u bë ndalimi i parë në histori për martesat të përzierat. Ky vendim motivohej nga filozofia e ruajtjes së fesë dhe racës, nga mbrojtja prej asimilimit. Nehemia dhe Ezra vendosën që të pesë Librat, Librat e Moisiut, apo Tora, të bëheshin të shenjtë dhe të mos lejoheshin të bëheshin ndryshime. Këta libra do të lexoheshin pjesë-pjesë me zë në çdo sinagogë të shtunave, gjatë një viti, për të filluar përsëri nga e para vitin e ardhshëm. Ky ritual vazhdon edhe sot, domethënë 2 500 vjet më pas.

Pesë Librave të Moisiut, apo Toras së kanonizuar, gradualisht iu shtuan edhe shkrime të tjera. Procesi përfundoi në vitin 300 para erës së re. Samaritanët, që u shkëputën nga Judeja në mijëvjeçarin e parë para erës së

re, ruajtën vetëm të Pesë Librat e Moisiut. Ata nuk u lejuan të merrnin pjesë në kanonizimin e shkrimeve të tjera dhe prandaj nuk i njohën ato. Më pas kemi atë që u quajt Septuagint, që është një version grek i Testamentit të Vjetër dhe që u hartua nga diaspora hebreje në Aleksandri gjatë periudhës helenistike. Kjo përmban të gjithë librat e Testamentit të Vjetër, por të renditur ndryshe.

Judea mbeti provincë persiane deri në vitin 332 para erës së re, kur Persia u mund nga Aleksandri i Madh. Në këtë kohë, Judea kaloi nën dominimin grek dhe kulturën greke.

Kur vdiq Aleksandri i Madh, perandoria e tij u nda midis gjeneralëve dhe Judea u kontrollua fillimisht nga pjesa e perandorisë që drejtohej nga Selucidi dhe më pas nga Ptolemeu.

Judea në këtë periudhë drejtohej nga Prifti i Lartë, i cili mbahej nën kontroll nga Sanhedrini, që ishte njëkohësisht Senati dhe Gjyqi i Lartë. Sanhedrini, kur vepronte si Gjyqi i Lartë, përbëhej nga 71 persona të zgjedhur nga familjet më të mira, nga njerëz me kulturë dhe të moralshëm. Sistemi hebre i drejtësisë ishte shumë më i përparuar sesa ai i vendeve të tjera, ku drejtësia bazohej jo në ligje, por në prova të fajësisë, që kryhej duke e vendosur të akuzuarin para provave të kërcënimit të jetës me mjete nga më të ndryshmet dhe për të parë, nëse do të ishte Zoti me të dhe do ta ndihmonte apo jo.

Për hebrenjtë, në këtë kohë, armiku kryesor ishte helenizimi që filloi në mënyrë gati të padukshme. Ai filloi me futjen e gjuhës greke dhe pastaj vazhdoi me ndryshimin e emrave, me ndryshimin e sjelljeve dhe zakoneve, me ndryshimin e moralit, etikës dhe fesë. Sinagogat filluan t'u ngjasonin tempujve grekë. Hebrenjtë, sipas kulturës hedoniste greke, nuk duhej të rendnin më pas detyrës dhe moralit, por pas qejfit. Ndonëse kultura greke u pranua nga një pjesë e hebrenjve, ajo shkaktoi edhe reagim të ashpër të pjesës tjetër që donte të ruante identitetin hebre. Kjo pjesë krijoi partinë politike që u quajt Hasidim dhe do të luante në të ardhmen një rol me rëndësi.

Në vitin 167 para erës së re, grekët çshenjtëruan Tempullin e Madh, duke urdhëruar vendosjen në të të një statuje të Zeusit dhe duke e kthyer atë në altar pagan, ku bëhej kurban derri dhe zhvilloheshin rite pagane. Në të zhvilloheshin lojëra greke nga djem hebrenj të zhveshur. Si reagim ndaj sjelljes së grekëve, hebrenjtë ngritën krye. Kryengritja më e famshme në

këtë kohë ka qenë ajo e drejtuar nga Juda Makabi, i cili mundi të hynte në Jerusalem dhe të shpëtonte Tempullin nga përdhosja. Ishte kryengritja e parë në histori që zhvillohej për motive fetare. Lufta zgjati mbi 25 vjet. Hebrejtë e rimorën Tempullin dhe në përkujtim të kësaj ngjarjeje, sot festohet dita e Hanukas.

Si pasojë e kryengritjeve, në vitin 140 para erës së re, Judea u njoh si shtet autonom, në të cilin do të sundonte dinastia hebreje e Hasamonëve, derisa në vitin 110 para erës së re, Judea u bë krejtësisht e pavarur. Gjatë kohës që Judea qe e pavarur, ajo zgjeroi kufijtë e vet, duke pushtuar Idumean në jug dhe Galilenë në veri dhe i detyroi popujt e atyre dy vendeve të ktheheshin nga paganë në judaistë. Më pas, nga Idumea do të dilte një mbret i urryer, Herodi, që do të sundonte Judenë dhe nga Galilea do të dilte Jezui, Krishti.

Gjatë marshimit drejt Lindjes, Roma pushtoi Judenë në vitin 63 para erës së re dhe e ktheu atë në një shtet vasal. Megjithatë dinastia e Hasamonëve jetoi deri në vitin 37 para erës së re, kur romakët i dhanë fund asaj dinastie, riorganizuan vendin dhe vunë Herodin si mbret të Judesë i cili, duke qenë me prejardhje nga Idumea, u kundërshtua nga shumë hebrejtë. Megjithatë, mbretërimi i Herodit pati sukses. Herodi e zmadhoi dhe e zhvilloi mbretërinë e tij dhe punoi për rindërtimin e Tempullit të Madh në Jerusalem që të fitonte besimin e hebrenjve, por vendosi aty simbolin romak të shqiponjës, gjë që shkaktoi përsëri protesta të hebrenjve.

Në këtë kohë, në Jude u formuan dy parti politike: Partia e Zelotëve (Partia e Luftës), që kërkonte luftë kundër Romës dhe Partia e Paqes që kërkonte qetësi. Partia e Zelotëve përbëhej nga esenët, farizinjtë dhe saducinjtë. Farizinjtë qenë më të shumtit, saducinjtë më të fuqishmit dhe esenët më të devotshmit. Partia e Paqes do të përbëhej nga një sekt i ri, nga të krishterët.

Në vitin 6 para erës së re, ndodhi kryengritja e parë e hebrenjve kundër Romës. Ajo u zhvillua nga zelotët. Romakët e shtypën me brutalitet atë kryengritje. Thuhet se ata kryqëzuan rreth 2 000 hebrejtë në rrethinat e Jerusalemit. Në këtë kohë Roma caktoi Priftin e Lartë të Judesë, hierarkinë fetare të saj si dhe një guvernator, që romakët e quanin prokurator, për të drejtuar qeverisjen e vendit. Një nga prokuratorët më famëkëqij do të ishte Pont Pilati. Qeverisja e Judesë nga guvernatorë romakë solli një varg pakënaqësish dhe kryengritjesh, të cilat nisën sidomos kur Perandori Kaligula kërkoi që të adhurohej si hyjni dhe të ngrihej për të një statujë

prej ari në Tempullin e Madh. Revolta e madhe, e fermentuar prej kohësh, shpërtheu në vitin 66 në të gjitha provincat hebreje. Romakët çuan në Jude garnizonet më të mira të komanduara nga gjenerali i famshëm Vespasian, i cili më pas do të bëhej perandor. Lufta zgjati katër vjet dhe përfundoi me shtypjen e hebrenjve dhe me shkatërrimin e Tempullit të Madh në vitin 70, përsëri, ashtu si disa qindra vjet më parë, në kohën e persianëve, në ditën e nëntë të muajit hebre të Avit. Pas shkatërrimit të Tempullit, qëndresa e hebrenjve zgjati edhe 4 vite të tjera. Ajo përfundoi në fortesën natyrore Masada, një kodër, jo larg Jerusalemit, në shkretëtirën Negev, ku shkuan e u strehuan luftëtarët hebrej më të vendosur së bashku me familjet e tyre. Në të thuhet se kryen vetëvrasje kolektive afro 1 000 luftëtarë hebrej. Burrat patën për detyrë të vrisnin gratë dhe fëmijët e tyre. Nga burrat e mbetur, u zgjodhën dhjetë prej tyre, të cilët patën për detyrë të vrisnin burrat e tjerë dhe prej këtyre të dhjetëve u zgjodh një që të vriste nëntë të tjerët dhe pastaj veten. Kështu u shuan të gjithë luftëtarët që u strehuan në Masada. Kur romakët hynë në Masada, u tmerruan nga pamjet që panë. Të gjithë të vdekur. Pas shkatërrimit të Tempullit romakët grabitën pasuritë e tij dhe i çuan në Romë. Nga ai Tempull mbeti vetëm Muri Perëndimor i tij, i cili është edhe sot.

Jeta fetare, e përqendruar kryesisht te Tempulli i Madh, pësoi ndryshime. Bashkë me shkatërrimin e Tempullit u shkatërrua edhe klasa e priftërinjve që deri në atë kohë kishte qenë klasa drejtuese dhe udhëheqësja fetare. Tashmë do të krijoheshin udhëheqës të rinj fetarë, që do të quheshin “rabin”, fjalë që do të thotë “mësues”. Këta, këtej e tutje, do të ngarkoheshin me riorganizimin e jetës fetare dhe, që prej kësaj kohe, judaizmi do të quhej judaizëm rabinist. Ky judaizëm do t’i kushtonte vëmendje kryesisht leximit dhe studimit të Torës dhe do të zbatonte me përpikëri rregullat fetare. Në këtë kohë morën rëndësi sinagogat si institute karakteristike të jetës hebraike. Fjala sinagogë ka prejardhje greke dhe do të thotë mbledhje, vend mbledhjeje. Sinagogat tani morën rëndësi të dorës së parë si vende studimi, lutjeje dhe mbledhjeje, kështu jeta fetare e hebrenjve u decentralizua krejtësisht. Periudha e judaizmit rabinik vazhdon edhe sot.

Në vitin 130, perandori romak Hadrian vizitoi rrënojat e Jerusalemit të lëna nga lufta e mëparshme e viteve 66-70. Ai e rindërtoi qytetin, i vuri emrin Aelia Kapitolina dhe e ktheu në qytet pagan. Hadriani ndërtoi një Tempull të madh të Perëndeshës Venus, që e prishën më pas për të

ndërtuar Kishën e Varrit të Shenjtë dhe në vendin ku ndodhej Tempulli i Madh hebre ngriti një Tempull për Jupiterin. Krahas ndërtimit të tempujve romakë në Jerusalem, Hadriani ndaloi hebrenjtë të kryenin synetllëkun, rit që, sipas tij, ishte barbar. Politikat antihebreje të Hadrianit shkaktuan revoltën e tretë të hebrenjve në vitin 132. Ajo revoltë u drejtua nga Simon Bar Kokhba, pasardhës i mbretit David, që konsiderohej edhe si Mesi dhe mbështetej nga shumë segmente të popullsisë. Hebrenjtë për ca kohë morën Jerusalem. Të krishterët nuk morën pjesë në atë revoltë, sepse Mesia i tyre ishte Krishti dhe jo Bar Kokhba. Hadriani për të shtypur kryengritjen çoi në Jude përsëri gjeneralë të zotë, me ushtri të shumta nga Europa. Revolta u shtyp pas tre vjetësh, në vitin 135, përsëri në ditën e nëntë të muajit hebre të Avit, në ditën që ishte shkatërruar edhe Tempulli i parë dhe i dytë në Jerusalem. Thuhet se gjatë asaj lufte u vranë rreth 580 000 hebrenj dhe u shkatërruan dhjetëra qytete e fshatra. Për të likuiduar përfundimisht kryengritjet e hebrenjve dhe judaizmin, Hadriani ndaloi Ligjet e Torës, kalendarin hebraik dhe vrau shumë dijetarë hebrenj. Për të shuar edhe gjurmët e Judesë, ai e emërtoi atë Palestinë, pra i vuri emrin e vendit të fisit armik të hebrenjve, të filistinëve. Që nga ajo kohë, hebrenjtë u dëbuan plotësisht dhe përfundimisht nga Judea, por u lejuan të futeshin në Jerusalem një herë në vit, në ditën e nëntë të muajit Av, për të vajtuar humbjen e qytetit dhe Tempullit.

Hebrenjtë andej e tutje do të hiqnin dorë nga lufta e armatosur dhe nuk do ta fillonin atë deri në shekullin e njëzetë. Goditja preventive, rezistenca e armatosur dhe hakmarrja kanë munguar plotësisht në historinë e tyre gjatë mërgimit. Revolta e tyre e fundit ishte kjo kundër Perandorisë Romake në fillim të shekullit të dytë, kur hebrenjtë jetonin në vendin e tyre.

Hebrenjtë e dëbuar nga Judea u shpërndanë nëpër botë: në Siri, në vende jo të largëta të Azisë, në Romë, në Spanjë, në Francë, në Gjermani etj. dhe formuan atë që do të quhej diasporë.

Në shekullin e parë pas erës së re popullsia hebraike në Perandorinë Romake përbëhej nga rreth 7 milionë njerëz, gjë që përbënte 10% të popullsisë së përgjithshme të asaj perandorie. Prej tyre, rreth 4 milionë ishin hebrenj nga prejardhja, të tjerët ishin paganë të ndryshëm, të konvertuar në fenë judaiste.

Kur kjo popullsi filloi të quhej hebraike dhe kush quhet hebre? Shumë e lidhin krijimin e popullit hebre me kohën kur ai popull mori me anë të

profetit të tij, Moisiut, urdhëresat e Zotit, pra kur u mor Tora në malin Sinai, rreth vitit 1200 para erës së re.

Në kohët biblike, fëmija e trashëgonte judaizmin përmes të atit. Fëmijët e Moisiut konsiderohen hebrej edhe pse nëna e tyre, Ziporah, nuk ishte hebreje. Sot, për hebrejtë ortodoksë, që të quhesh hebre, duhet të kesh lindur nga një nënë hebreje, ose të jesh konvertuar në hebre sipas procedurave mjaft të vështira. Hebrejtë ortodoksë konsiderojnë si hebre një fëmijë të lindur nga prindër hebrej, pavarësisht nga qëndrimi i mëvonshëm i prindërve kundrejt fesë, madje edhe kur ata e kanë braktisur fenë e tyre, apo kur e kanë pagëzuar fëmijën e tyre si të krishterë që në lindje. Hebraizmi i fëmijës është një e drejtë e tij e lindjes, të cilën nuk mund t'ia heqin prindërit. Sipas ligjit judaist, një që ka lindur hebre, apo është konvertuar sipas rregullave në hebre, e ka atë status për jetë, edhe kur ai ndërron fenë: “po të jesh një herë hebre, je për jetë hebre”. Për hebrejtë, Karl Marksi, Hainrih Hajne, Feliks Mendelson Bartoldi janë hebrej judaistë, edhe pse ata vetë janë kthyer në të krishterë. Hebrejtë thonë: “është e vështirë të jesh hebre, por është edhe më e vështirë të përpiqesh të mos jesh”.

Për shumë hebrej, feja luan pak rol në përcaktimin e tyre si hebrej. Ata besojnë se hebraizmi ka të bëjë më shumë me një aleancë etnike, pra me përkatësinë e popullit hebre, ndërsa besimet fetare luajnë rol të rendit të dytë. Shumica e hebrejve e konsiderojnë veten e tyre si pjesëtarë të së njëjtës familje.

Hebrejtë nuk janë racë. Ata nuk kanë tipare racore që i kanë vetëm ata dhe nuk i ka asnjë popull tjetër. Hebrejtë, të shpërndarë në të gjithë botën, kanë marrë tipare të racave të ndryshme dhe njerëz nga raca të ndryshme janë kthyer në hebrej gjatë historisë. Shumë etiopianë të racës së zezë e konsiderojnë veten hebrej dhe një numër i madh kanë shkuar në Izrael si hebrej.

Në shekullin e dytë shumica e hebrejve ishin pa atdhe, të shpërndarë kudo në Perandorinë Romake. Megjithatë, ata nuk e humbën njëri-tjetrin, ata nuk humbën në tregjet e skllëvërve, ata nuk e humbën gjuhën, ata nuk e humbën trashëgiminë, ata i mbajti të bashkuar feja. Për të ruajtur gjuhën në këtë kohë, u hartua gramatika dhe fjalori i parë hebraik. Që atëherë, hebraishtja pati pak ndryshime. Një hebre i sotëm mund të lexojë dhe të kuptojë pa vështirësi hebraishten e asaj kohe. Për të unifikuar fenë

u standardizua liturgjia në sinagoga. Hebrenjtë u organizuan në grupe të vogla. Sapo 120 meshkuj të moshës mbi trembëdhjetë vjeç jetonin në një zonë, ata krijonin një komunitet social me një sinagogë, me një gjykatë, që gjykonte mosmarrëveshjet sipas ligjeve hebraike, pa hyrë në konflikt me ligjet e vendit ku jetonin. Ky komunitet i impononte vetes taksa, përveç taksave të qeverisë. Taksa e tyre, e cila jepej në formë ndihme, duhej të ishte rreth 10 për qind e të ardhurave të tyre. Sipas tyre: duhet ta ndihmosh të varfrin në përputhje me nevojat e tij, por nuk je i detyruar ta bësh atë të pasur. Taksat e komunitetit shërbenin për ta bërë atë komunitet të pavarur nga qeveria dhe përdoreshin kryesisht për arsim dhe bamirësi. Asnjë në komunitet nuk duhej të vuante nga uria, asnjë hebre nuk duhej të kërkonte lëmoshë nga qeveria. Çdo komunitet do të kishte shkollën e vet që do të siguronte arsim të përgjithshëm. Arsimimi ishte i detyruar për të gjithë djemtë. Vajzat nuk e kishin arsimin të detyruar, por as të ndaluar. Arsimtarët paguheshin mirë, në mënyrë që ta bënë profesionin e mësimdhënies tërheqës dhe të respektuar. Me këto rregulla dhe me të tjera, që përcaktonin marrëdhëniet e hebrenjve me popujt e feve të tjera, hebrenjtë mundën të mbijetonin si hebrenj deri në rënien e Perandorisë Romake.

JEZUI DHE TESTAMENTI I RI SIPAS TË KRISHTERËVE

Burimi i vetëm nga ku mësohet jeta e Jezuit, janë katër Ungjijtë që përbëjnë Testamentin e Ri. Ata janë shkruar pas vdekjes së Jezuit nga teologë dhe jo nga historianë. Kështu, ata Ungjij janë më shumë dokumente teologjike sesa kronika historike. Ungjijtë janë shkruar, sipas radhës, nga Mateu, Marku, Luka dhe Gjoni. Ata flasin për lindjen e Jezuit, pak fare për fëmijërinë e tij dhe pastaj kalojnë te veprimtaria e tij nga mosha 30-vjeçare, deri kur kryqëzohet në moshën 35-37-vjeçare. Për autorët e Ungjijve nuk dihet gjë.

Emri *Krisht* është emër grek dhe është përkthimi në greqisht i emrit hebre *Mesi*, që do të thotë “i vajosuri, i dërguari, i ngarkuari me një detyrë të shenjtë prej Zotit” dhe që i atribuohet Jezuit.

Jezui (Joshua) u lind dhe u rrit si hebre nga prindër hebrej. Ai nuk shkoi kurrë në kishë, ai nuk festoi kurrë Pashkët e krishtera. Fëmijëria e tij ishte si ajo e fëmijëve të tjerë hebrej të kohës. Ai ishte bërë synet që në ditën e tetë nga lindja, ashtu si bëheshin edhe fëmijët e tjerë hebrej, kishte kryer ritin e *bar mitzvas* në moshën 13-vjeçare, rit sipas të cilit djali merrte atributet e burrit dhe bëhej i përgjegjshëm për zbatimin e ligjit hebre, lutej në sinagogë, mësonte Biblën Hebraike, vishej e mbahej si hebre, hante ushqimet e lejuara për hebrejtë (ushqime kosher), fliste hebraisht dhe gjuhën aramaike, që ishte edhe gjuha, si të thuash, ndërkombëtare e popullsisë të Lindjes së Mesme të asaj kohe.

Jezui nuk pati për qëllim nisjen e një feje të re, por kërkoi që njerëzit t’i bindeshin vullnetit të Zotit dhe vullneti i Zotit gjendej te Ligji i Moisiut. Te Mateu, 5:17, 18, ai thotë: “Mos mendoni se kam ardhur të rrëzoj Ligjin, apo profetët. Nuk kam ardhur t’i përmbys ata, por kam ardhur që t’i realizoj ata”. Mësimet e tij ishin të thjeshta, praktike dhe etike. Ato ishin edhe mendimet dhe thëniet e profetëve hebrej para tij. Ai zgjodhi prej tyre parime morale dhe humane dhe u dha jetë. Jezui u mësoi pasuesve vlerën e individit, rëndësinë e ndershmërisë dhe moralit, besimin se jeta ka një qëllim, idenë e shërbimit ndaj tjetrit dhe mbajtjen e një qëndrimi